



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VI**

*Sesioni pranveror*

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. **16**

Prishtinë, më 24.4.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Besa Gaxherri, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Danush Ademi, Ganimete Musliu, Enver Hoti, Salih Salihu, Sërgjan Mitroviq dhe Liburn Aliu.

Mungoi : Driton Çausi.

Mbledhjen e kryesoi, **Daut Haradinaj**, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i 5 procesverbaleve të fundit të Komisionit;
3. Shqyrtimi i strategjisë shtetërore për ujëra në Kosovë 2017-2036,
4. Shqyrtimi i raportit vjetor për vitin 2017 nga Autoriteti Rregullator për Ujëra,
5. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i 5 procesverbaleve të fundit të Komisionit;**

**Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit**, konstatoi miratimin e procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara me disa vërejtje, ndërsa **Besa Gaxherri**, pati vërejtje, duke thënë se “asgjë nuk kuptohet çka kam thënë në këtë procesverbal të datës 28.3.2018”, pohim ky të cilin e mbështeti edhe **Ganimete Musliu**, por nuk pati ndonjë vërejtje konkrete.

**Daut Haradinaj**, për të procesverbalet tha se janë të qarta, kurse **Lutfi Zharku**, kërkoi përmirësimin tek diskutimi për “Jupa”-ve ngase bëhet fjalë për mbiemër.

**3. Shqyrtimi i strategjisë shtetërore për ujëra 2017-2036;**

**Baton Begolli**, i ftuar nga komisioni për këtë pikë, si përfaqësues i Këshillit Ndërministror për Ujëra, fillimisht sqaroi pse është vonuar dërgimi i strategjisë në Kuvend, ngase siç theksoi është

dashur të rishqyrtohet disa herë. Strategjia e ujërave është kompletuar në vitin 2014, me financim të KE-së, pastaj i është dorëzuar Këshillit Ndërmintor për Ujërat për shqyrtim dhe përditësim. Shkaku i zgjedhjeve dhe vonesave administrative, strategjia është marr në shqyrtim dhe përditësim, pra në vitin 2017 dhe është miratuar nga Qeveria në fund të vitit.

Strategjia është dokument voluminoz, por nuk pati disponim atëherë që të reduktohet në përmbajtje. Tani, kemi mbetur peng të këtij dokumenti, meqë komuniteti i donatorëve kërkon të kemi një strategji për sektorin e ujërave, në bazë të cilës parashtrihen kërkesat për financim.

Strategjia trajton resurset ujore, mbrojtjen e tyre, zhvillimin (resurse të reja), shfrytëzimin kryesisht shërbimet ujore, dhe më pak çështjen e përmbajtjeve dhe hidroenergjisë dhe më pas paraqiti të gjeturat.

Një shtet konsiderohet të ketë ujë të mjaftueshëm (pa stres ujor) nëse ka mbi 1700 m<sup>3</sup>/banor/vit, por Kosova në përgjithësi ka mungesë të ujërave në 4 pellgjet kryesore, ku Drini i Bardhë = 1674 m<sup>3</sup>/b/v dhe Morava e Binçes = 1045 m<sup>3</sup>/b/v kanë stres ujor, kurse Ibri = 827 m<sup>3</sup>/b/v dhe Lepenci = 1000 m<sup>3</sup>/b/v kanë mungesë të theksuar të ujit! Akumulimet për kokë banori janë 290 m<sup>3</sup> në krahasim me 696 m<sup>3</sup>, pra vetëm 42% të rajonit! Të reshurat vjetore për kokë banori janë 4,107 m<sup>3</sup> në krahasim me rajonin 10,705 m<sup>3</sup>, pra vetëm 41% të rajonit! Këto argumente shtrojnë nevojën për mbrojtjen e resurseve aktuale dhe zhvillimin e resurseve të reja ujore.

Pra, është me rëndësi për Qeverinë, por dhe Kuvendin që të sigurojnë mbrojtjen e resurseve ekzistuese dhe zhvillimin e resurseve të reja, për të përmbushur nevojat e zhvillimit.

Në anën tjetër, gjendja me shërbime të ujit (me shifra të përditësuara përtej atyre në strategji të nxjerr që nga një projekt i përbashkët kosovaro-zviceran) është si në vijim: 84.32% të popullatës kanë mbulueshmëri me rrjet publik dhe 7.26% refuzojnë të bartin rrjetin në menaxhim. 8.42% e banorëve nuk kanë qasje në ujësjellës.

Sa i përket qasjes në kanalizim fekal, 72.5% kanë qasje në rrjet, 11.6% , anë qasje pjesërisht dhe 15.9% të vendbanimeve nuk kanë qasje në rrjetin e kanalizimit Humbjet janë diku rreth 56%.

Vlen të theksohet se Kosova është vlerësuar nga organizata ndërkombëtare si model për rajonin dhe përtej në aspektin e qeverisjes së ujërave, që përfshin organizimin e sektorit. Me këtë nënkuptojmë ndarjen e përgjegjësive institucionale në mes të resurseve ujore (MMPH) dhe shërbimeve të ujit (MZHE), por që po na ndodh që të kemi ndërhyrje, e ku Kuvendi mund të luaj rolin e vet, sidomos kur vijmë tek miratimi i buxhetit, pra të bëhet sipas përgjegjësive institucionale.

**Daut Haradinaj**, falënderoi për sqarimet e dhëna, por veçoi disa kundërthënie me atë çka u dëgjua nga z. Begolli, ngase Kosova faktikisht ka tepër humbje të ujërave, madje ndoshta edhe mbi 75%, që do të thotë se menaxhimi nuk është në nivelin e duhur. Kemi politizimin e bordeve, ndryshimin negativ të nivelit të kompanive nga komunale në regjionale, pra kemi menaxhim jo të suksesshëm dhe shumë kontradikta të tjera.

Haradinaj , pyeti z. Begolli, se ku është në praktikë uji për të cilin flet ai, ngase mori shembuj disa vende (Reka e Keqe etj.), ku uji as që depërton andej, kurse ekzistimi i rrjetit pa ujë, ajo është çështje tjetër. Nëse ka fakte të tjera , kërkoj që këto shënime ti dërgohen komisionit, ndërkohë që shumica e anëtarëve të komisionit patën pyetje dhe kërkesa të ngjashme.

**Ganimete Musliu**, paraqiti shqetësimin e saj për ujin e pijshëm, duke përmendur dy vizitat e bëra në liqenin e Batllavës dhe atë të Badofcit. Përreth liqenit të Batllavës ka stalla të kafshëve dhe ujërat e tyre derdhen direkt në liqe. Gjithashtu, edhe në liqenin e Badofcit ka shumë mbeturina dhe pyeti a është planifikuar diçka për parandalimin e ndotjes, pasi që janë jashtë kujdesit institucional.

**Salih Salihu**, theksoi se kjo strategji është voluminoze por nuk ka përmbajtjen e duhur serioze, pikërisht sepse uji është ai që sjell bukën. Drini Bardhë, vazhdoi ai, me 1647 metra kub sa i përfshin shkon dhe rrjedh në Danub pa pasur asnjë tentim nga shteti për ndonjë akumulim të ujit apo digë etj. Gjithkund në botë bien shi por ka periudha të thata kur nuk ka të reshura, për çka duhet të mendojë shteti duke akumuluar ujë ngase direkt kemi të bëjmë me zhvillimin ekonomik

dhe kjo do të thotë se duhet të lihet anash ndonjë projekt i autostradës, në favor të ndonjë projekti ujor. Ai pyeti se a parashihet me këtë strategji ndonjë plan në dobi të akumulimit të ujit dhe a ka afate.

**Enver Hoti** paraqiti shqetësimin e ekzistimit të ndonjë rruge tjetër të zhvillimit, nëse jo me kredi, dhe sa humb ujë konsumatori dhe sa humbin ujë kompanitë pasi po ekziston favorizimi i kompanive për shkak të pagesave të rregullta.

Hoti kërkoi të sqarohet se a ka plane Qeveria për ndërtimin e digave të mëdha, pasi që përkushtimi dhe mbështetja parlamentare për këtë çështje nuk do të mungonte.

**Liburn Aliu**, u fokusua në çështjen parësore të investimeve për ujëra, kush i bënë ato dhe mori shembuj konkret me disa diga të filluara, por asnjëherë të përfunduara, nga të cilat asnjëra nuk mund të thuash se është një dhe komplet.

Aliu iu bashkëngjiti vërejtjeve të cekura nga kryetari me shembuj konkret, si atë në Greme, ku tha se ka rrjet, por nuk ka ujë.

**Sërgjan Mitroviq**, shprehu kënaqësinë rreth shqyrtimit të këtyre çështjeve ujore, por potencoi se këto politika ujore duhet të harmonizohen me ato të BE-së, sidomos me fondin IPARD rreth ujitjeve dhe përkrahu qasjen e Salih Salihut për akumulimin e ujërave, të cilat ndikojnë direkt në zhvillimin e ekonomisë edhe bujqësisë.

**Baton Begolli**, si përfaqësues i këshillit ndërministror për ujëra, tha se shumica e kërkesave që u parashtruan nga komisioni i perkasin MMPH-së, përndryshe ai përsëriti se Kosova në rajon është e njohur për një reformim shumë pozitiv nga aspekti i ujërave dhe qëndron më mirë se sa disa kryeqytete të njohura të Ballkanit, përveç Korçës, e cila ka shkuar më së largu sa i përket kursimit të ujit.

Në lidhje me bordet, Begolli pranoi se ka politizime, duke e rritur pa nevojë stafin etj. Ministria e Bujqësisë duhet të zëvendësojë nivelin lokal ngase është shpenzues i madh i ujit, për ujin e pijshëm është kompetent IKSHP-ja.

Tash sa kohë që gjendet në Qeveri, Begolli tha se gjithmonë ka gjetur mirëkuptim për këtë çështje madhore, ndërsa për Badofcin dhe Batllavën potencoi se ekziston një vendim por jo vetëm ujësjellësi mund të zgjidhë këto probleme.

Me rastin e sqarimit rreth borxheve, **Enver Hoti**, pyeti se a ka qëndrim zyrtar për mosshfrytëzimin e kredive apo si sqarohet zhvillimi i një vendi vetëm me donacione.

Begolli theksoi se prioritetet i caktojnë MMPH-ja, MZHE-ja dhe MI-ja, kurse për master planin, tha se ai është që nga viti 1983, por tani jemi në fazën e hartimit të fizibilitetit.

**Lutfi Zharku pyeti se si** është e mundur të përparohet ujësjellësi me grande, duke mos shfrytëzuar kredi, kush është ai që na jep 1 miliard grande.

Pas debatit, Komisioni vendosi nxori këtë :

## REKOMANDIM

**Mbledhja plenare të miratoi strategjinë shtetërore të ujërave për periudhën 2017-2036.**

### 4. Raporti vjetor 2017 i ARRU-s;

**Raif Preteni, drejtor:** Duke marrë parasysh se viti 2017 ka shënuar vitin e fundit të procesit tarifor 2015 – 2017, ndër angazhimet kryesore të ARRU-s, gjatë këtij viti ka qenë përcaktimi i tarifave për periudhën e ardhshme trevjeçare – Procesi Tarifor 2018 – 2020.

Tarifa fikse për konsumatorët shtëpiak për shërbimet e ujit vazhdon mbetet e njëjta që nga 2005-2006 në vlerën 1.00 €/muaj, ndërsa konsumatorët joshtëpiak, duke filluar nga viti 2018, do të ngarkohen me nga 2.00 €/ në muaj, për dallim prej 3.00€/ në muaj sa kanë paguar deri më tani.

Vlen të ceket se gjatë tri viteve të fundit, nuk ka pasur asnjë ngritje të tarifave për shërbimet e ujit, ndërsa gjatë vitit 2018, në nivel të sektorit, tarifat volumetrike kumulative (për ujë dhe ujëra të ndotura) për konsumatorët shtëpiakë në nivel të sektorit, janë rritur për një cent (nga 42 centë, në 43 centë), kurse tarifat kumulative (për ujë dhe ujëra të ndotura) për konsumatorët institucional dhe komercial, janë ulur për dy cent (nga 88 centë, në 86 centë). Zbritja e tarifave për konsumatorët joshtëpiakë ka ndodhur për arsye të reduktimit të shkallës së ndërsbvencionimit në mes të konsumatorëve shtëpiakë dhe konsumatorëve joshtëpiakë.

Tarifat volumetrike në Kosovë, janë më të ulëtat në nivel të rajonit, siç edhe është paraqitur në tabelën nr. 2 të Raportit.

Duhet theksuar se procesi i përcaktimit të tarifave për ujin me shumicë të përpunuar për pjesën veriore, është proces i ndarë me procesin e përcaktimit të tarifave të ujit për konsumatorët e Regjionit të Mitrovicës. Konsumatorët e pjesës jugore nuk paguajnë faturat për pjesën veriore, respektivisht nuk kanë tarifa më të larta si pasojë e mospagesës nga qytetarët e pjesës veriore.

Faturat për pjesën veriore nuk i pranon askush edhe pse me Urdhëresën Tarifore të Shërbimit për Ujin, me shumicë të përpunuar në pikën 6 (gjashtë), theksohet se KRU Mitrovica duhet të lidhë kontratë me autoritetet e pjesës veriore për furnizim me ujë të pijes me shumicë.

Me qëllim verifikimit të zbatimit të legjislacionit aktual nga ana e ofruesve të shërbimeve dhe mbrojtjes së konsumatorëve, ARRU-ja ka zhvilluar inspektime gjatë tërë vitit, dhe për të gjitha shkeljet e gjetura ofruesit e shërbimeve janë obliguar të bëjnë përmirësimet dhe kompensimet eventuale. Si rezultat i këtij aktiviteti:

-Janë kompensuar 721 konsumatorë, me nga 45€, të cilët edhe përkundër zbritjes së taksës për kyçje (nga ana e ARRU) në 5€, janë ngarkuar nga ofruesit e shërbimeve me 50€.

-Janë kompensuar 133 konsumatorë me nga 100€, të cilët edhe përkundër mënjanimet të taksës (gjobës) për kyçje ilegale, janë gjobitur nga ofruesit e shërbimeve me nga 100€.

-Janë gjetur mbingarkesa tek rreth 300 konsumatorë (të ndërtesave të banimit kolektiv) të cilët faturohen sipas paushallit të aprovuar nga ARRU, kompensimi i këtyre konsumatorëve ka filluar dhe është në proces.

-Janë vendosur matësit e ujit të përpunuar dhe nga 65% i matjes së ujit të përpunuar niveli i matjes ka arritur në 100%.

Me qëllim të përmbushjes së rekomandimeve të Raportit të Avokatit të Popullit (ex officio) të datës 11.1.2017, lidhur me faturimin e konsumatorëve në ndërtesat e banimit kolektiv, të cilët faturohen përmes ujëmatësit të përbashkët, është zhvilluar inspektim tek të gjithë ofruesit e shërbimeve me ç'rast është gjetur se KRU "Prishtina" nuk i përmbahet metodave të aprovuara nga ARRU për faturimin e kësaj kategorie të konsumatorëve. Për këtë rast ARRU-ja ka proceduar Paralajmërim, dhe do të ndërmarrë hapat ligjor pas përmbushjes së afatit të dhënë në Paralajmërim. Gjithashtu përmes shkresës (ex officio) të datës 18.7.2017 Avokati i Popullit ka ngritur çështjen e faturimit të ujit të shpenzuar në veri të Kosovës, dhe ka kërkuar sqarime nga ARRU-ja për këtë çështje.

Për të dy rastet e ngritura nga Avokati i Popullit, pas sqarimeve, inspektimeve dhe takimeve të mbajtura, Avokati i Popullit ka paraqitur të gjeturat në "Raportin Vjetor për vitin 2017 të Avokatit të Popullit".

Sipas këtij Raporti, sa i përket faturimit të konsumatorëve në ndërtesat e banimit kolektiv është konkluduar se: "...çështja e faturimit dhe çështja e monitorimit të operatorëve të licencuar është mirë e normuar nga ARRU-ja me Rregulloren për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë. Po ashtu, nga një raport që Avokati i Popullit ka pranuar nga ARRU-ja, raportohet se ARRU-ja zhvillon inspektime të rregullta edhe në terren si dhe ndërmerr masa në rastet e mungesës së përmbushjes së standardeve minimale për shërbimet e ujit."

Sa i përket çështjes së faturimit të ujit të shpenzuar në veri të Kosovës, në raport është konkluduar se: "... rasti i furnizimit me ujë të pjesës veriore të Mitrovicës dallon nga rasti i

furnizimit dhe faturimit të rrymës së shpenzuar në atë pjesë, sepse sipas përgjigjes së ARRU-s ujësjellësi rajonal KRU Mitrovica furnizon pjesën veriore të qytetit me ujë, me çmim e ujit të shitjes me shumicë dhe se qytetarët e pjesës tjetër të qytetit nuk paguajnë për pjesën veriore, është Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) e cila kohë pas kohe, sipas mundësive buxhetore, e subvencionin KRU Mitrovica për të mbuluar shpenzimet dhe për të bërë të mundur operimin e ndërmarrjes....”

Inspektimet e lartpërmendura dhe inspektimet tjera të zhvilluara gjatë vitit 2017, i gjeni më të detajuara në Raportin e ARRU-s.

Në pajtim me nenin 48 të ligjit Nr. 05/L-042, gjatë vitit 2017, ARRU-ja ka shqyrtuar dhe aprovuar gjithsejtë 35 akte interne (Rregullore dhe plane) të ofruesve të shërbimeve.

Si çdo vit, ARRU-ja edhe në vitin 2017, duke u bazuar në Ligjin aktual ka publikuar raportin e performancës për të gjitha KRU-t.

Të dhënat e shfrytëzuara për analizën e përbushjes së caqeve për vitin 2017, dhe performanca e KRU-s, në këtë raport, janë të dhëna të paaudituar (meqenëse pasqyrat financiare ende nuk janë përmbyllur), ndërsa të dhënat e vitit 2016 janë të verifikuara me procesin e auditimit. Të dhënat e vitit 2017 do të saktësohen pas përmbylljes së fazës së auditimit.

Performanca e KRU-ve, është përshkruar në nënkapitullin 5.6 të këtij raporti, e që ka të bëjë me inkasimit =, humbjet e ujit dhe tregues tjerë kyç të performancës.

Në kuadër të Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK), të cilat janë formuar dhe veprojnë me përkrahje të plotë nga ana e ARRU-s, janë mbajtur 92 takime dhe janë shqyrtuar gjithsej 266 ankesa të konsumatorëve të pakënaqur me përgjigjet e marra në ankesat e tyre drejtuar ofruesve të shërbimeve.

Me qëllim të përcaktimit të objektivave dhe përbushjes së obligimeve ligjore, është përpiluar plani strategjik 3 vjeçar, 2018 – 2021.

Bashkëpunimi me palët brenda dhe jashtë vendit ka qenë një ndër aktivitetet e ARRU-s edhe gjatë vitit 2017. Janë përgatitur dhe dorëzuar raportet sipas kërkesave të institucioneve të ndryshme, siç janë: MIE, MZHE, DANUBIS, IBNET, WAREG, etj.

Vlen të theksohet se ARRU-ja është pranuar si anëtare me të drejta të plota në Rrjetin e Rregullatorëve Evropianë të Ujit (WAREG) me të drejta të barabarta - përmes së cilës është hapur mundësia e bashkëpunimi teknik dhe institucional mes Rregullatorëve, si dhe zhvillimi i dialogut me institucionet përkatëse të sektorit të ujit në nivel Evropian dhe ndërkombëtar.

Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit me “Komisionin për Ndërmarrje Publike” të Letonisë, institucion rregullator). Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje mundëson bashkëpunim më të ngushtë në të gjitha çështjet rregullatore.

Në fund, por jo për nga rëndësia, për arsye të vështirësive ligjore të cilat janë krijuar me miratimin e Ligjit për Kundërvajtje Nr.05/L-087 dhe shqetësimeve tjera të ngritura nga ofruesit e shërbimeve, sipas udhëzimeve nga ana juaj, është iniciuar plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit. Sugjerimet dhe komentet e ARRU-s i kemi përcjellë te komisioni përkatës dhe shpresojmë shumë në përkrahjen tuaj për procedim të shpejtë.

**Daut Haradinaj, kryetar** u ndërlidh me problemin e pjesës veriore, për të cilin komisioni shpejt do të dal me rekomandime konkrete, pasi që koncentrimi duhet të përqendrohet patjetër edhe në këtë pjesë të Kosovës dhe pyeti për ngritje tarifash për individë, kurse drejtori e arsyetoi këtë ngase partnerët komercialë janë të rregullt në pagesa, por kjo është një përqindje shumë e vogël. Kryetari sugjeroi që gjatë takimeve në GP-në për ndryshimin e ligjit të shqyrtohen këto mundësi për rregullimin e tarifave, dhe pyeti për disa probleme në Obiliq (liqeni kancerogjen -puce) për të cilat drejtori tha se nuk është në kompetencën e ARRU-s, sepse ky autoritet ka të bëjë me 7 kompanitë publike, prandaj me problemet në Obiliq duhet të merret Komuna e Obiliqit.

**Besa Gaxherri** pyeti për ujëmatësit sa për qind janë të instaluar në nivel vendi dhe çfarë propozimi konkret ka për zgjidhjen e problemit të ujëmatësve në banesa kolektive, ndërsa drejtori për këtë tha se ujëmatës në nivel të Kosovës kemi 90%, ndërsa shqetësimi për banesat kolektive, potencoi se nuk ekziston më ky problem, ngase për secilën banesë veç e veç miren shenimet sa shpenzohet.

**Enver Hoti** pyeti për disa çështje organizative brenda ARRU-s, mosplotësimin e dy vendeve të punës, pse për objektin e ri paguhet qiraja aq shumë dhe a ka mundësi kjo çështje të rregullohet? Pse nuk paguajnë konsumatorët dhe bizneset njësoj (për këtë pyetje u sqarua drejtori edhe më herët), po ashtu edhe komunat paguajnë ndryshe (për këtë çështje drejtori tha secila komunë ka kushte të ndryshme, ngase ajo komunë që ka ramjen e lirë të ujit, normal se nuk i nevojitet energjia etj), pse për investime kapitale në raport ekziston vetëm një tabelë e vogël, përgjigja ishte se këto janë në balancim e sipër.

Komisioni edhe për raportin vjetor të ARRU-s paraqiti këtë :

## REKOMANDIM

**Të miratohet nga mbledhja plenare raporti vjetor 2017 i ARRU-s.**

**Të ndryshme.**

**Daut Haradinaj, kryetar,** në për këtë pikë, ftoi komisionin të vendosë për rishpalljen e konkursit për drejtor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, ngase dy kandidatët e propozuar, nuk kaluan në votim në mbledhjen plenare.

Komisioni njëzëri vendosi për rishpalljen e konkursit për këtë pozitë, kurse anëtarë të GP për Projektligjin e veprimtarive hidrometeorologjike u caktuan : Andin Hoti, kryesues, Danush Ademi dhe Salih Salihu anëtarë.

**Rreth kërkesës së Shoqatës së tregtuesve të imputeve bujqësore,** kryetari njoftoi komisionin se ka zhvilluar veprimet e nevojshme dhe ia ka dërguar komisionit shkresën me të cilën njofton për veprimet e ndërmarra nga ai dhe MB-ja.

Në fund kryetari njoftoi edhe për disa veprimtari që i ndërmerr USAID-i rreth mbjelljes së kulturave të ndryshme (boronicë et.j), të cilat janë dobiprurëse për fermerët tanë.

Mbledhja përfundoi në orën 12,14.

E përgatiti:

**Stafi mbështetës i Komisionit.**

Kryetari i Komisionit,

**Daut Haradinaj**